REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-6158/25 datë:24.03.2026

Npi – 01/65 datë: 02.04.2026

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 02.04.2026, miratoi:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E NENIT 6.9 TË RREGULLORES TË PUNËS SË KUVENDIT DHE KOMITETEVE Npi-01/155 TË DATËS 27.04.2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 02.04.2026, unanimisht miratoi, Vendimin për ndryshimin e Nenit 6.9 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/155 të datës 27.04.2023,
Nga formulimi ekzistues në Rregullore si vijon: ***"Kërkesat e palëve që paraqiten te zyra pritëse, duhet fillimisht të adresohen te Ekzekutivi i Komunës përkatësisht te Drejtoria Kompetente, dhe pastaj nëse Drejtoria e konstaton se kërkesa duhet të adresohet në Kuvend ajo e transferon Kërkesën e palës në zyrën e Kuvendit së bashku me rekomandimin e sajë."***
Në formulimin e ri si vijon: "Kërkesat e palëve dorëzohen në Arkivin e Komunës, i cili bënë pranimin, evidentimin dhe shpërndarjen e tyre sipas adresimit të bërë nga pala. Zyrtari përgjegjës i Arkivit, pas pranimit dhe regjistrimit të kërkesës, e përcjell atë drejtpërdrejt te organi kompetent, përfshirë Kuvendin e Komunës apo drejtoritë përkatëse, në përputhje me përmbajtjen dhe adresimin e kërkesës, pa qenë e nevojshme që kërkesa të kalojë paraprakisht nëpërmjet Ekzekutivit të Komunës."

II

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, MAPL-së, dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME ŠTIMLJE

v.v.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi